

## E DREJTA PËR INFORMIM



### Indeksi i transparencës së autoriteteve publike qendrore/varësisë dhe njësive të vetëqeverisjes vendore

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale publikon për vitin e tretë radhazi Raportet mbi “Indeksin e Transparencës së Autoriteteve Publike Qendrore dhe të Varësisë 2022” dhe “Indeksin e Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore 2022”.

Këto indekse ndjekin një metodologji të caktuar, e cila shërben kryesisht për të sjellë një analizë krahasuese të nivelit të transparencës proaktive të autoriteteve publike, duke krahasuar trendin e transparencës së tyre ndër vite. Gjetjet e këtyre raporteve synojnë jo vetëm të nxisin ndërgjegjësimin për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, si dhe rritjen e nivelit të transparencës përmes publikimit proaktiv të informacionit, por shërbejnë dhe si referencë përpara vendimmarrjes së Zyrës së Komisionerit në respektim të dispozitave ligjore.

Në konkluzion të monitorimit të autoriteteve publike gjatë vitit 2022, vërejmë se kemi një rritje të transparencës proaktive, duke marrë në konsideratë edhe faktin se në këtë metodologji janë përdorur 8 indikatorë për autoritetet publike qendrore/varësisë dhe 9 indikatorë për njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilët i korrespondojnë po aq kategorive të informacionit publik pa kërkesë, që duhet të jenë të publikuara në faqen zyrtare.

Dy indekset mund të konsultohen në faqen zyrtare të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

# Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit janar 2023



Me anë të vendimit nr.2, datë 19.01.2023, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj Autoritetit Publik, Bashkia Krujë, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare", kundër Autoritetit Publik "Bashkia Krujë" (në vijim "Autoriteti Publik").

Ankuesi, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") Formularin e Ankesës, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare", kundër Autoritetit Publik/Bashkia Krujë (në vijim "Autoriteti Publik").

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës depozituar në adresën e postës elektronike të koordinatorit, ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni në lidhje me:

- 1.Kopje të kontratës së bashkëpunimit mes Bashkisë Krujë dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim AADF, për krijimin e TID Kruja;
- 2.Kopje të statutit të TID Kruja;
- 3.Në çfarë kapaciteti është Bashkia Krujë palë në këtë iniciativë? Cili është roli i saj dhe fuqia vendimmarrëse në çështjet e menaxhimit të këtij entiteti?
- 4.Cili kuadër ligjor është përdorur për krijimin e këtyre entiteteve dhe vënien në dispozicion të pronës publike për zhvillim.

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, në përfundim të afatit ligjor, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënie e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa është në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe ankuesi legjitimohet në kërkimin e tij.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e

mundur", Zyra e Komisionerit nëpërmjet shkresës nr. 1940/1 prot., datë 14.11.2022, drejtuar Autoritetit Publik dhe për dijeni ankuesit, ka kërkuar të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar, në vijim të së cilës nuk pati një reagim nga ky autoritet.

Ankuesi me anë të e-mail-it ka informuar Zyrën e Komisionerit se: "...dëshiroj t'ju informoj se edhe pas komunikimit me përfaqësuesit e Bashkisë Krujë dhe zotimit të këtyre të fundit për dhënie e informacionit brenda një afati sa më të shkurtër, deri më sot nuk kam pasur asnjë komunikim për sa i përket kësaj kërkesë...", duke vijuar në këtë mënyrë ankimin.

Në këto kushte, pas shqyrtimit të objektit të ankimit si dhe konsultimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2 të LDI, sipas të cilit "informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".

Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI, ku përcaktohet se: "Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim". Bazuar në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: "Autoritet publik" është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të

prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj".

Në kuptim të këtij parashikimi, Bashkia e Krujës është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: "1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e "prodhuesit" apo "mbajtësit" të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike.

Bazuar në pikën 3, të nenit 3 të LDI, "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit".

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP [www.idp.al](http://www.idp.al).

## PËRMBLEDHJE MUJORE E VENDIMEVE

Vendim Nr. 2 -Bashkia Krujë

# Partneritet për rritjen e transparencës në funksion të interesit publik

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile (OjF) dhe median është me rëndësi në funksion të ndërgjegjësimit për ushtrimin e të drejtave e lirive themelore të qytetarëve.



Zyra e Komisionerit zhvilloi një takim konsultativ me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga OjF dhe media për të diskutuar rreth ecurisë së zbatimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, arritjet apo problematikat e hasura gjatë zbatimit të tij, si dhe fokusin e veprimtarisë së institucionit për vitin 2023. Në këtë takim u vlerësua kjo iniciativë e Zyrës së Komisionerit, e cila forcon partneritetin për qëllimin e përbashkët, nxitjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës së autoriteteve publike. Nëpërmjet ndërveprimit, sidomos duke marrë parasysh rolin dhe kontributin e organizatave të shoqërisë civile dhe medias për demokratizimin dhe zhvillimin e shoqërisë, pjesëmarrësit u angazhuan që kjo nismë të vijohet e të konsolidohet për shkëmbim idesh e qëndrimesh në funksion të interesit publik.

# Komiteti i Planifikimit të ICIC: Edicioni i XIV i Konferencës


Zyra e Komisionerit iu bashkua për vitin e dytë rradhazi Komitetit të Planifikimit të edicionit XIV të ICIC-së. Pjesëmarrja aktive në grupe ndërkombëtare pune e Zyrës së Komisionerit është një ndër objektivat që parashikohet edhe në strategjinë institucionale 2022 - 2025 dhe planin vjetor të punës. Komiteti për këtë edicion përbëhet nga anëtarët e autoritetit mexikan INAI, filipinas dhe atij shqiptar. Puna e Komitetit përqendrohet kryesisht tek përmbajtja e konferencës si përcaktimi i temave, identifikimi i folësve dhe panelistëve, ofrimi i sugjerimeve në kuadër të organizimit me qëllim përgatitjen e një programi sa më të përshtatshëm dhe të efektshëm që i përgjigjet nevojave dhe adresimit të çështjeve aktuale të transparencës në nivel ndërkombëtar, i cili do të kontribuojë në përparimin e punës dhe objektivave strategjik të forumit më të rëndësishëm global të transparencës dhe aksesit në informacion. Komiteti i Planifikimit raporton rregullisht pranë Komitetit Ekzekutiv të ICIC mbi ecurinë e përgatitjeve të konferencës dhe punën e kryer nga Komiteti. Në takimin e parë *online* të Komitetit, autoriteti filipinas paraqiti një prezantim të përgjithshëm lidhur me masat e marra në kuadër të përgatitjeve për konferencën. Zyra e Komisionerit dhe autoriteti mexikan i cili ka dhe rolin e sekretariatit të konferencës, dhanë disa sugjerime dhe diskutuan mbi temën e Konferencës dhe programin për këtë edicion, si edhe lidhur me aspekte të tjera përgatitore. Komiteti miratoi gjithashtu edhe kalendarin e takimeve deri në zhvillimin e konferencës. Zyra e Komisionerit do të jetë organizatore e konferencës në vitin 2024.



**Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:**



[idp.albania](https://www.instagram.com/idp.albania)



[IDP Albania](https://twitter.com/IDPAlbania)



[Komisioneri KDIMDP](https://www.youtube.com/KomisioneriKDMDP)